



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.757/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.757/2021 i datës 03.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar që të bëhet verifikimi i votave të saj (në Komunën e Prizrenit).

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 me të cilën ka pretenduar se ka mospërputhje të rezultateve të saja në listën e shpallur nga KQZ-ja në fletët FRP të publikuara nga KQZ. Në këtë formular të publikuar rezultati është 175 vota derisa në rezultatet përfundimtare të publikuara me datë 03.11.2021 nga KQZ numri total i votave për parashtruesen e apelit është 157 vota. Andaj ka kërkuar nga PZAP të verifikojë votat e saja. Si dëshmi krahas apelit ka paraqitur formularët FRP të publikuar nga KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Burbuqe Berisha, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Prizren më të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, e në rastin konkret, Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluesja që ishin Formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga të cilat formularë rezultoi se kandidatja për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kishte gjithsej 155 vota e jo 175 ashtu siç edhe pretendon në apel. Ndër të tjera nga rezultatet zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rezultoi se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren Burbuqe Berisha ka gjithsej 157 vota.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Burbuqe Berisha kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.757/2021 më datën 05.11.2021**

**Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Glllogjani**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.757/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.757/2021 i datës 03.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar që të bëhet verifikimi i votave të saj (në Komunën e Prizrenit).

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 03.11.2021 me të cilën ka pretenduar se ka mospërputhje të rezultateve të saja në listën e shpallur nga KQZ-ja në fletët FRP të publikuara nga KQZ. Në këtë formular të publikuar rezultati është 175 vota derisa në rezultatet përfundimtare të publikuara me datë 03.11.2021 nga KQZ numri total i votave për parashtresën e apelit është 157 vota. Andaj ka kërkuar nga PZAP të verifikojë votat e saja. Si dëshmi krahas apelit ka paraqitur formularët FRP të publikuar nga KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Burbuqe Berisha, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Prizren më të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, e në rastin konkret, Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluesja që ishin Formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga të cilat formularë rezultoi se kandidatja për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, Burbuqe Berisha nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kishte gjithsej 155 vota e jo 175 ashtu siç edhe pretendon në apel. Ndër të tjera nga rezultatet zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rezultoi se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Prizren Burbuqe Berisha ka gjithsej 157 vota.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Burbuqe Berisha kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.757/2021 më datën 05.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllgjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.